

A.nr.690/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.690/2026, të datës 23.06.2026, të parashtruar nga ankuesi M.T, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat B. P nga Shtërpca, kundër organit të punësimit Komunës së Klllokotit, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.690/2026, të datës 23.06.2026, të parashtruar nga ankuesi M.T.

II. Lënda delegohet për shqyrtim tek Komisioni i Ankesave në Komunën e Klllokotit.

A r s y e t i m

Ankuesi M.T (*me tej referuar vetëm ankuesit*), përmes përfaqësuesit të tij më datë 23.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 1/2026 të datës 30.04.2026 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Klllokotit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 25.06.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klllokotit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 06.07.2026, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, *sepse*:

Nga provat e lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Marrëveshjes së Punës me numër protokolli 1874/2 të datës 04.10.2019, është i punësuar në pozitën Teknik Mjekësor në Ambulanten e Mjekësisë Familjare në Komunën e Klllokotit.

Drejtoresha për arsimin, shëndetësinë, shërbimet sociale, kulturën, rininë dhe sportin, më atë 10.02.2026, ka paraqitur kërkesë për nisjen e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të Komisionit Disiplinor të Komunës së Klllokotit.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Klllokotit, më datë 30.04.2026, ka nxjerr Vendim me Nr. 1/2026, me të cilin ankuesin e ka bërë përgjegjës për shkelje disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *Ndalim i tridhjetë përqind (30%) të pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë muaj.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 1/2026 të datës 30.04.2026 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Klllokotit, pretendon se nuk është vërtetuar gjendja faktike për faktin që nuk kam kryer asnjë shkelje disiplinore. Kërkon të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të obligohet Komuna e Klllokotit që të anuloj vendimin për ndalimin e pagës.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me çështjen në procedurë ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin përcaktohet se: *Kategoritë e zyrtarëve/publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe përformuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit. 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. 3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës...”, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton se të gjithë të punësuarit në kuadër të institucioneve publike shëndetësore të Kosovës që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta, përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik, dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi rezulton fakti se pozita e ankuesit është pozitë me status të nëpunësit të shërbimit publik. Andaj, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka kompetenca lëndore për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, sepse, duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.*

Sipas Vendimit me Nr. 1/2026 të datës 30.04.2026 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Klllokotit, gjegjësisht sipas **Këshillës Juridike: Pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në KPMSHCK, brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e marrjes së vendimit për masën disiplinore**, Kolegji i Këshillit, konstaton se duke marr parasysh faktin se ankuesi ka statusin e nëpunësit të shërbimit publik, i njëjti duhet udhëzuar për mjetin juridik në Komisionin e Ankesave të Shërbimit Publikë në Komunën e Klllokotit, mirëpo pavarësisht këshillës juridike të vendimit të kontestuar, Kolegji i Këshillit, në kuptim të udhëzimit të palës ankuese lidhur me të drejtën në mjete juridike, vë theksin të neni 8 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 27 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se : *“Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave”*, pra, zyrtarët publikë të kategorisë së shërbimit publik dhe të kategorisë administrative mbështetëse, në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënie e punës, fillimisht mund të parashtrojnë ankesë tek punëdhënësi i cili themelon një Komision të Ankesave në pajtim me kërkesat ligjore, e më pastaj, duke ju referuar përcaktimeve ligjore sipas nenit 77 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, mund të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente duke ndjekur procedurën e paraparë më nenin 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës ku shprehimisht thuhet se: **Neni 79, paragrafi 1** *“... 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente...”*

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.401/2026, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë të brendshme pranë organit të punësimit, atëherë, në kuptim të nenit 75 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda delegohet tek Komisioni i Ankesave i Komunës së Klllokotit.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda; A.nr.690/2026, datë 21/07/2026

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit , Avokat B.P;
- Organit të Punësimit: Komisionit të Ankesave dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klllokotit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.



A.br.690/2026

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova – Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, u sastavu: Arben Mehmeti, predsednik, Ardita Haxhnikaj-Demi i Malsore Gashi-Bajraktari, članovi, i Avdyl Bekteshi, u svojstvu zapisničara, u postupku po žalbi pod brojem A.br.690/2026, od 23.06.2026. godine, koju je uložio podnosilac žalbe M.T, kojeg po ovlašćenju zastupa advokat B.P iz Štrpca, protiv organa zapošljavanja opštine Klokot, po pravnoj stvari „disciplinska mera“, postupajući u skladu sa članom 6. stav 1 podstav 1.1, članom 16. stav 3 i članom 18. stav 1. podstav 1.8 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, dana 21.07.2026.godine, donelo je ovu:

ODLUKU

I. Oglašava se nenadležnim Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova da odlučuje o žalbi A.br.690/2026, od 23.06.2026.godine, koju je uložio podnosilac žalbe M.T.

II. Predmet se delegira na razmatranje Komisiji za žalbe u opštini Klokot.

Obrazloženje

Podnosilac žalbe M.T (*u daljem tekstu samo podnosilac žalbe*), preko svog zastupnika, dana 23.06.2026.godine, uložio je žalbu u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, protiv Odluke br.1/2026 od 30.04.2026.godine doneta od Disciplinske komisije opštine Klokot.

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova (*u daljem tekstu: Odbor*), na osnovu odredbi Pravilnika br.02/2018 o Proceduri razmatranja i rešavanja žalbi u Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, dana 25.06.2026.godine, procesuirao je zahtev za odgovor na žalbu upućen opštini Klokot, pa je opština Klokot dana 06.07.2026. godine, prosledila odgovor na žalbu.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, nakon razmatranja predmetnih spisa, zaključuje da Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova nije nadležan da odlučuje o žalbi koju je uložio podnosilac žalbe, **jer:**

Iz dokaza u predmetu proizilazi da je podnosilac žalbe, shodno Ugovoru o radu broj protokola 1874/2 od 04.10.2019.godine, zaposlen na radnom mestu- Medicinski tehničar u Ambulanti porodične medicine u opštini Klokot.

Direktorica za obrazovanje, zdravstvo, socijalne usluge, kulturu, omladinu i sport, dana 10.02.2026. godine, podnela je Disciplinskoj komisiji opštine Klokot zahtev o pokretanju disciplinskog postupka protiv podnosioca žalbe.

Disciplinska komisija opštine Klokot, dana 30.04.2026. godine, donela je Odluku br.1/2026, kojom je podnosioca žalbe proglasila odgovornim za disciplinsko kršenje, izričući mu disciplinsku meru *Obustava trideset posto (30%) osnovne plate za jedan period u trajanju do šest meseci*.

Žalioc, u žalbi podnetoj Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, protiv Odluke br.1/2026 od 30.04.2026.godine Disciplinske komisije opštine Klokot, tvrdi da činjenično stanje nije dokazano, zbog činjenice da nije počinio nikakav disciplinski prekršaj. Zahteva da se žalba usvoji, da se osporena odluka poništi i da se opština Klokot obaveže da poništi odluku o obustavi plate.

U pogledu utvrđivanja stvarne nadležnosti Odbora za odlučivanje o predmetnoj stvari u žalbenom postupku, Veće Odbora pozvalo se na odredbe člana 5. Zakona br.08/L-197 o Javnim službenicima, koji propisuje da: *Kategorije javnih službenika/ice su: 1.1. Službenik/ica civilne službe; 1.2.Službenik/ica u javnoj službi; 1.3.Stvaralac i izvođač umetnosti i kulture; 1.4.Tehnički i pomoćni radnik/ica; i 1.5.Službenik/ica kabineta. 2.Službenik u civilnoj službi je javni službenik/ica unutar civilne službe koji učestvuje u formulisanju i/ili sprovođenju politika, monitorisanju primene pravila i upravnih postupaka i pruža opštu stručnu i administrativnu podršku u sprovođenju. Civilni službenik/ica obavlja svoje dužnosti na odgovarajućoj poziciji, počevši od profesionalnog službenika/ica do pozicije višeg rukovodioca, u administraciji predsednika Republike Kosovo, u administraciji Skupštine Republike Kosovo, u Uredu premijera Republike Kosovo, u ministarstvima, u izvršnim agencijama i njihovim lokalnim ograncima, nezavisnim ustavnim institucijama, u nezavisnim i regulatornim agencijama, u opštinskoj upravi i svaki službenik/ica čiji je status civilnog službenika utvrđen posebnim zakonom. 3.Službenik/ica javne službe je javni službenik/ica koji pruža neposredne javne usluge građanima u oblastima obrazovanja, zdravstva, kulture, umetnosti, u oblasti sudske medicine, kao i drugim sličnim javnim uslugama. Službenik/ica javne službe obavlja svoje dužnosti na odgovarajućoj poziciji, počevši od profesionalnog nivoa do višeg rukovodećeg nivoa. Službenik/ica je takođe civilni službenik unutrašnjih službi u delu državne uprave, u administraciji javnih službi ili delu opštine...* ", te stoga, u smislu ovih zakonskih odredbi, proizilazi da svi zaposleni u javnim zdravstvenim ustanovama na Kosovu koji pružaju neposredne usluge, uključujući službenike višeg rukovodećeg, izvršnog, profesionalnog nivoa i službenike unutrašnje službe, imaju status službenika javne službe, te kao rezultat ovog propisa, proizilazi činjenica je da je pozicija podnosioca žalbe pozicija sa statusom službenika javne službe. Stoga, Veće zaključuje da Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, nema stvarnu nadležnost da odlučuje o žalbi podnosioca žalbe, jer je, na osnovu člana 6. stav 1 podstav 1.1. Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, Odbor nadležan samo za razmatranje žalbi civilnih službenika i kandidata za prijem u civilnu službu.

Shodno Odluci br.1/2026 od 30.04.2026.godine doneta od Disciplinske komisije opštine Klokot, odnosno prema **Pravnoj pouci: Nezadovoljna strana može podneti žalbu u NNOC SK, u roku od trideset (30) dana od dana donošenja odluke o disciplinskoj meri**, Veće Odbora zaključuje da uzimajući u obzir činjenicu da podnosilac žalbe ima status službenika javne službe, istog treba uputiti na pravni lek u Komisiji za žalbe javne službe u opštini Klokot, ali, bez obzira na pravnu pouku osporene odluke, Veće Odbora, u smislu pouke podnosioca žalbe u vezi s pravom na pravne lekove, naglašava član 8. Zakona br.08/L-294 o izmeni i dopuni Zakona br.08/L-197 o Javnim službenicima, u vezi s članom 27. Zakona br.08/L-197 o Javnim službenicima, koji propisuje da: „*Službenik javne službe i tehnički i pomoćni radnik imaju pravo podneti žalbu Komisiji za žalbe koju je formirao poslodavac, zbog bilo koje radnje ili propusta koji krše prava ili legitimne interese koji proizlaze iz radnog odnosa. Vlada, na predlog ministarstva nadležnog za javnu upravu, podzakonskim aktom utvrđuje postupak i pravila za formiranje, sastav i mandat Komisije za žalbe.* Dakle, javni službenici kategorije javne službe i kategorije administrativne podrške, u slučaju tvrdnji o kršenju njihovih prava koja proizlaze iz radnog odnosa, mogu prvo podneti žalbu poslodavcu koji će formirati Komisiju za žalbe u skladu sa zakonskim zahtevima, a zatim, pozivajući se na zakonske odredbe iz člana 77. Zakona br.08/L-197 o Javnim službenicima, mogu podneti tužbu nadležnom Sudu, sledeći postupak predviđen članovima 78. i 79. Zakona br.03/L-212 o Radu, koji izričito navodi da: **Član 79. stav 1. „... 1. zaposleni koji smatra da je poslodavac prekršio pravo iz radnog odnosa, može podneti zahtev poslodavcu ili nadležnom organu poslodavca, ako postoji, za ostvarivanje prekršenih prava. 2. Poslodavac je dužan da odluči o zahtevu zaposlenog, u roku od petnaest (15) dana od dana primanja zahteva. Član 79. stav 1: Svaki zaposleni koji nije zadovoljan odlukom kojom smatra da su mu prekršena prava ili ne dobije odgovor u roku propisanom članom 78. stavom 2. ovog zakona, može u roku od narednih trideset (30) dana, pokrenuti radni spor pred nadležnim Sudom...**”

Uzimajući u obzir gorenavedeni zaključak da Odbor nema nadležnost da odlučuje o žalbi A.br.401/2026, i budući da spisi predmeta utvrđuju činjenicu da podnosilac žalbe nije podneo unutrašnju žalbu organu zapošljavanja, onda se, u skladu sa članom 75. Zakona br. 05/L-031 o Opštem upravnom postupku, predmet delegira Komisiji za žalbe opštine Klokot.

Na osnovu gorenavedenog i u skladu sa članom 18. stav 1, podstav 1.8 Zakona br.06/L048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, Veće Odbora odlučilo je kao u dispozitivu ove odluke.

Odluka stupa na snagu danom potpisivanja od strane predsednika Veća.

Pravna pouka: Protiv odluke Odbora, nezadovoljna stranka može pokrenuti upravni spor u Upravni sud u Prištini-Odeljenje za Radne sporove, u roku od trideset (30) dana od dana kada joj je predata odluka. Pokretanje upravnog spora ne zadržava izvršenje ove odluke.

NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
Predmet; A.br.690/2026, od 21.07.2026.godine

Avdyl BEKTESHI

Zapisničar

Arben MEHMETI

Predsednik Veća

Odluku dostaviti:

- Ovlašćenom zastupniku podnosioca žalbe, advokatu B. P;
- Organu zapošljavanja: Komisiji za žalbe i rukovodiocu Jedinice za ljudske resurse u opštini Klokot; i
- Arhivi NNOCSK-a.

Preveo:
Sh.Mujko

Dana, 21.07.2026.god.